

VENDIM
Nr. 236, datë 14.4.2021

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË GODINËS SË KOPSHTIT PUBLIK DHE TË GODINËS SË BASHKISË VORË, BASHKIA VORË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË VORË SI NJËSI ZBATUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 707 302 333 (shtatëqind e shtatë milionë e treqind e dy mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të godinës së kopshtit publik dhe të godinës së Bashkisë Vorë, Bashkia Vorë, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) rindërtimi i godinës së kopshtit publik, Bashkia Vorë, në masën 88 433 787 (tetëdhjetë e tetë milionë e katërqind e tridhjetë e tre mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH;

b) rindërtimi i godinës së Bashkisë Vorë, në masën 618 868 546 (gjashtëqind e tetëmbëdhjetë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e dyzet e gjashtë lekë) lekë pa TVSH.

2. Bashkisë Vorë, për vitin 2021, i transferohet fondi në masën 141 460 466 (njëqind e dyzet e një milionë e katërqind e gjashtëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) për rindërtimin e godinës së kopshtit publik, Bashkia Vorë, në vlerën 17 686 757 (shtatëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH;

b) për rindërtimin e godinës së Bashkisë Vorë, Bashkia Vorë, në vlerën 123 773 709 (njëqind e njëzet e tre milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e nëntë) lekë pa TVSH.

3. Caktimin e Bashkisë Vorë si njësi zbatuese për rindërtimin e godinës së kopshtit publik dhe të godinës së Bashkisë Vorë, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe